



**Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE
№ 003/2019**

Data: 17 Korrik 2019

Zyrtar për informim

Prishtinë (Ref. №: AKKVP 006/2019)

Niveli: Koeficienti 7; Grada 9

Mbajtësi i detyrës është përgjegjës për zbatimin e strategjive të AKKVP-së për komunikim me publikun, informim dhe media.

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional;
- Shërben si personi kontaktues i Agjencisë për kontakte me media;
- Bashkërendon dhe shkruan komunikata dhe deklarata për media;
- Organizon dhe përgatit takime informative me gazetarë dhe intervista për media;
- Monitoron të gjitha mediet për çështjet relevante, zgjeron dhe mirëmban një regjistër të monitorimit të medieve;
- Harton materiale për botim, përfshirë dokumente për historikun për gazetarët, njoftime për shtyp, informatat për publikim, artikujt nga faqet e internetit dhe artikujt të tjerë për botim.

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diplomë Universitare në Gazetari, komunikim ose ndonjë fushë tjetër relevante;
- Së paku dy (2) vjet përvojë relevante në gazetari, marrëdhënie me publikun ose ndonjë punë tjetër që ka të bëjë me media;
- Shkathësi të mira krijuese dhe shkrimi formal, (kandidatët do të testohen);
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe serbe dhe njohja e gjuhës angleze; (kandidatët do të testohen në të gjitha/dy gjuhët); dhe
- Njohje e shkëlqyeshme e aplikacioneve në kompjuter.

Udhëheqës i Divizionit për Verifikim

Prishtinë (Ref. №: AKKVP 007/2019)

Niveli: Koeficienti 10; Grada 6

Sigurimi i zbatimit procedurave ligjore lidhur me kontroll të cilësisë së verifikimit të dokumenteve në gjithë Agjencinë.

- Siguron që verifikimi i dokumenteve të bëhet në pajtim me kushtet e parashtruara në procedurat standarde operative për verifikim;
- Bën kontrollimin e saktësis dhe të cilësis të raporteve të përpiluara si rezultat nga verifikimi i kryer fillestar dhe Aprovon-miraton Raportin e konsoliduar të verifikimit;
- Mbikëqyrë punën e divizionit të verifikimit, përcakton prioritetet, dinamikën, obligimet dhe përgjegjësit në realizimin e objektivave të përcaktuara, kujdeset për ruajtjen dokumentacionit eventual me të cilin ngarkohet divizioni i verifikimit, ndihmon në trajnim dhe ofron mbështetje gjithë stafit që punon në verifikim;
- Bën kontrollimin kryesor të kërkesave që kthehen nga NJPK/KKP/KVVP dhe kontrollon të dhënat e siguruar nga AKK/të paraqitura nga zyrtar rajonale; 10%
- Sipas kërkesës së Udhëheqësit, përgatit dhe azhuron statistikat e përgjithshme për divizionin e verifikimit për nevoja të brendshme; 10%
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diplomë universitare në drejtësi;
- Së paku pesë (5) vjet përvojë profesionale në fusha përkatëse;
- Aftësi të shkëlqyeshme analitike, komunikative, negociimi, koordinimi, menaxheriale dhe ndër-personale;
- Njohja e punës me kompjuter, të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Të jetë i përkushtuar ndaj barazisë, paanësisë, integritetit dhe të drejtave të njeriut;
- Aftësi për të mbikëqyruar dhe udhëhequr stafin.

Kjo pozitë është përcaktuar si pozitë e karrierës në bazë të paragrafit 1.1 të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Shënim: Procedura e rekrutimit është e rregulluar me Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm, si dhe nëpunës civilë ekzistues.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Detajet lidhur me përshkrimin dhe kushtet e punës për këtë pozitë mund të shkarkohen nga www.kpcva.org/jobs apo mund të merren në të gjitha zyrtar e AKKVP-së.

Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë online përmes AKKVP ueb faqes: <http://kpcva.org/punesim.aspx>

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pa kompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Zyrrën e Burimeve Njerëzore përmes postës elektronike në: recruit@kpcva.org

Afati i fundit për të paraqitur aplikacionet është 31 Korrik 2019

ZYRAT E AKKVP /KPCVA OFFICES/KANCELARIJE KAUVI-a

Medllin Ollbrajt rr./ul/st. nr./br/no. 199, tel. 0280 320 289, fax. 0280 324 067. **Mitrovicë/Mitrovica;** Shemsi Ahmeti nni, tel. 028 530 136/7, fax. 028 530 139, **Pjesa Veriore e Mitrovicës/Severnii deo Mitrovicë;** Filip Visnjic (ndertesa e Trepces/ zgrada Trepce / Trepca building) kati/sprat/floor 2 nr.18. **Pejë/Peć;** Mbretëresha Teutë str. No.85, tel. 039 431 668, fax. 039 432 970. **Prishtinë/Priština;** Rexhep Luci/ ex Goleška str. No.6 , tel. 038 225 473, fax. 038 244 854. **Prizren;** Jeronim De Rada, str. No: 74 (prapa qendrës tragtare - Ben Af /behind shopping center - Ben Af / iza tržnog centra – Ben Af) , tel. 029 231 469, fax. 029 231 429.

www.kpcva.org

Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71/UL "Perandori Justinian" Br. 71/ Str. "Perandori Justinian" No. 71

10 000, Prishtinë/Priština - Tel: +383 (0)38 249-918 Fax: + 383 (0) 38 249 919